

DEKRET
Nr. 78, datë 6.6.2023

PËR EMËRIMIN E GJYQTARIT TË GJYKATËS SË LARTË

Në mbështetje të nenit 93 dhe nenit 136, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe nenit 48, pika 13, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas administrimit pranë Institucionit të Presidentit të Republikës më datë 29.5.2023 dhe pas propozimit të arsyetuar të Këshillit të Lartë Gjyqësor, përcjellë me shkresën nr. 3028/2 prot., datë 29.5.2023, dhe me vendimin nr. 270, datë 25.5.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, “Për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë të kandidatës znj. Enkelejda Metaliaj”, për pozicionin e lirë në fushën e të drejtës administrative, të shpallur me vendimin nr. 535, datë 17.11.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor,

DEKRETOJ:

Neni 1

Zonja Enkelejda Metaliaj emërohet gjyqtar i Gjykatës së Lartë nga radhët e gjyqtarëve.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj